



EUROPEAN UNION

**Office of The Auditor General
Zyra e Revizionit Gjeneral
Kancelarija Generalnog Revizora**

UNMIK



Nr. i Dokumentit: 22.3.1-2006-08

**RAPORTI I AUDITIMIT MBI PASQYRAT FINANCIARE NË
KOMUNEN E GJAKOVËS PËR VITIN E
PËRFUNDUAR MË 31.12. 2006**

Prishtinë, Nëntor 2007

PËRMBAJTJA

Faqe

	Përmbledhje e përgjithshme	
1.	Hyrje	3
1.1	Korniza e auditimit	3
1.2	Fushëveprimi i auditimit të Komunës për vitin 2006	4
1.3	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA)	4
1.4	Struktura e raportit	5
2	Raportimi i të dhënave financiare	5
3	Çështjet që ndikojnë në dhënien e opinionit	6
3.1	Opinionit i Auditimit	6
4	Sistemi i Kontrollit të Brendshëm	6
5.	Të hyrat	7
5.1	Hyrje	7
5.1.1	Tëhyrat nga burimet vetjake	7
5.1.2	Të hyrat nga kadastra - gjeodozia	8
5.2	Harmonizimet	9
6	Shpenzimet	9
6.1	Paga dhe mëditje	10
6.2	Mallra shërbime dhe Investime Kapitale	10
7	Menaxhimi i Pasurisë	11
8	Përcjellja e implementimit të Rekomandimeve nga vitet e mëhershme	11
Aneksi 1	Të gjeturat, ndikimet dhe rekomandimet	12
Aneksi 2	Përgjigjja ndaj komenteve të Komunës	27

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Auditimi i pasqyrave financiare në komunën e Gjakovës (me tutje Komuna) është kryer nga Zyra e Revizionit të Gjeneral (me tutje ZRGJ).

Çështjet kyçe të cilat kanë ndikuar në refuzimin e opinionit për llogarit janë diskutuar në kaptinën 3 siç janë; mungesa e kontrollit për menaxhimin e pasurive, si dhe çështjet në prokurim dhe në paga e mëditje. .

Në aneksin 1, kemi paraqitur të gjeturat, ndikimin dhe rekomandimet. Bazuar në rregulloren 2002/18 ZRGJ-ja kërkon nga menaxhmenti i lartë i Komunës që të ndërmarrë veprime korrigjues lidhur me rekomandimet.

1. Hyrje

Duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/9 Për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë kreun 8.1(e) dhe (x) kreun 11.1 (c) si dhe në Rregulloren e UNMIK-ut 2002/18 mbi themelimin e Zyrës së Revizorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Revizionit të Kosovës nenin 3.2 dhe 4.4. Zyra e Revizionit Gjeneral në Kosovë ka kryer auditimin në Komunë për periudhën prej 01.01.2006 deri me 31.12.2006.

1.1 Korniza e auditimit

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/18 më datë 04 tetor 2002, krijon bazën ligjore të ZAGJ në Kosovë. Sipas nenit 3.2 të kësaj rregulloreje, nga Auditori Gjeneral kërkohet të kryej auditimin e rregullt vjetor të të gjitha institucioneve të Kosovës, duke përfshirë:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Përkatësinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm;
- Ndershmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative të zbatuara në kuadër të institucionit ose të entitetit që iu është nënshtruar auditimit; si dhe
- Të gjitha çështjet të cilat dalin ose kanë të bëjnë me auditimin;

Në muajin mars të vitit 2003, Kuvendi i Kosovës e ka nxjerr Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 2003/2 (LMFPP), i cili ligj edhe formalisht është shpallur nga PSSP- me Rregulloren nr 2003/17 të datës 12 maj 2003.

1.2 Fushëveprimi i auditimit të Komunës për vitin 2006

Objektiva primare e këtij auditimi është që t'i mundësohet ZRGJ-së që ta japë opinionin nëse pasqyrat financiare të Komunës japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë për të hyrat e arkëtuara dhe shpenzimet e kryera gjatë vitit i cili ka përfunduar më 31 dhjetor 2006, si dhe nëse janë përgatitur në pajtim me Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik (SNKSP) lidhur me "raportimin financiar sipas kontabilitetit të parasë së gatshme". SNKSP-të janë nxjerr nga Bordi i standardeve ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik (BSNASP) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK).

1.3 Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA)

Pasqyrat financiare të Komunës për vitin 2006 kanë qenë subjekt i auditimit të pavarur i cili është realizuar në pajtim me SNA-të e Bordit të standardeve ndërkombëtare të auditimit, i cili funksionon si organ i veçantë në kuadër të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) të standardeve ndërkombëtare të zbatueshme për sektorin publik. Këto standarde e përcaktojnë kornizën ndërkombëtare sipas së cilës Zyra e Auditorit të Përgjithshëm duhet t'i kryejë detyrat dhe t'i përfshijë çështjet siç janë, parimet dhe përgjegjësitë e përgjithshme, vlerësimi i rrezikut dhe përgjigjet ndaj rreziqeve të vlerësuara, dëshmitë e auditimit, mbështetja në punë e të tjerëve dhe konkluzionet si dhe raportimi i auditimit.

Standardi i caktuar Ndërkombëtar i Auditimit që përcakton konkluzionet e auditimit dhe të raportimit, siguron formën dhe të shprehurit standard i cili duhet të adoptohet kur një auditor jep një opinion të qartë ose të pandryshuar të auditimit, si dhe udhëzojnë se kur një auditor duhet të japë një opinion të kualifikuar ose të modifikuar të auditimit.

Një opinion i modifikuar i auditimit duhet të jepet për këto situata vijuese:

- kur auditori vjen në përfundim që sipas të dhënave të marra të auditimit, pasqyrat financiare nuk janë pa gabime materiale për shkak të mospajtimit me menaxhmentin lidhur me (i) pranueshmërinë e politikave të zgjedhura të kontabilitetit, (ii) zbatimin e politikave të zgjedhura të kontabilitetit ose (iii) përshtatshmërinë e shpalosjes në pasqyrat financiare. Prandaj, auditori vjen në përfundim që pasqyrat financiare nuk janë përgatitur nga të gjitha aspektet në pajtim me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar; apo
- kur auditori nuk mund të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse të auditimit për të arritur në përfundim që pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Pas kësaj, auditori e jep gjykimin profesional lidhur me materialitetin dhe shtrirjen e ndikimit të çështjes duke i dhënë rëndësi ndryshimit për marrjen e vendimit lidhur me llojin e opinionit i cili duhet të lëshohet, si në tabelën më poshtë:

Natyra e çështjes e cila i jep rëndësi ndryshimit	Ndikimet ose ndikimet e mundshme të pasqyrave financiare	
	Materiale	Materiale dhe ndikuese
Mospajtimi me udhëheqjen	Opinion i kualifikuar	Opinion i kundërt
Pamundësia për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse	Opinion i kualifikuar	Refuzim i opinionit

Nga kjo rrjedh që refuzimi i opinionit lëshohet atëherë kur auditorët nuk mund të përcaktojnë nëse zërat e renditur në pasqyrat financiare janë apo mund të jetë të ndikuara nga pamundësia e tyre për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse dhe për shkak që është vështirë ose e pamundur për ata që t'i përshkruajnë qartë ndikimet lidhur me pasqyrat financiare në raportet e tyre të auditimit. Kështu, për pasqyrat financiare nuk është dhënë asnjë opinion.

1.4 Struktura e raportit

Hyrja në kaptinën 1 shoqërohet me kaptinat vijuese të cilët shtjellojnë këto pika:

- Kaptina 2 Raportimi i të dhënave financiare
- Kaptina 3 Çështjet që ndikojnë në dhënjën e Opinionit
- Kaptina 4 Sisitemi i kontrollit te brendshem
- Kaptina 5 Të hyrat
- Kaptina 6 Shpenzimet
- Kaptina 7 Menaxhimi i Pasurisë
- Kaptina 8 Përcjellja e implementimit te rekomandimeve nga vitet e mëhershme

2. Raportimi i të dhënave financiare

Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave e ka nxjerr Udhëzimin Administrativ nr. 2006/14 mbi Raportimin e Organizatave Buxhetore, me të cilin obligohen që të paraqesin raporte financiare për parane e gatshme sipas Standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik. Afati i fundit për raportim ka qenë 31 janar 2007.

Ne kemi bërë auditimin e pasqyrave financiare të Komunës për vitin 2006. Këto pasqyra janë përgjegjësi e menaxhmentit të Komunës.

3. Çështjet që ndikojnë në dhënien e opinionit

Çështjet kyçe të cilat ndikojnë në opinionin e ZRGJ-së lidhur me pasqyrat financiare të entitetit janë si në vijim:

- Sistemi i Kontrollit të Brendshëm në Komunë është i dobët, sidomos në regjistrimin dhe inkasimin e të hyrave vetjake si dhe në menaxhimin e pasurive.
- ZRGJ-ja ka vërejtur papajtueshmëri me Ligjin e Prokurimit Publik nr. 2003/17 të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/3.

Të gjeturat e paraqitur në aneksin 1, kryesisht janë identifikuar në kategoritë : pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet si dhe në menaxhimin e pasurive. Këto të gjetura janë paraqitur dhe diskutuar me subjektin e auditimit si dhe janë inkorporuar korrigjimet dhe dëshmitë e tjera. ZRGJ-ja shfrytëzon rastin që t'ia paraqesë në hollësi udhëheqjes së lartë rekomandimet në bazë të gjeturave.

3.1. Opinioni i Auditimit

Për arsye të rëndësishme të çështjeve paraprake të përmendura në paragrafët me lartë, ne nuk do ta japim opinionin lidhur me pasqyrat financiare të Komunës për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2006.

Pasqyrat Financiare nuk janë përgatitur në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të pranuar të sektorit publik për raportimin financiar të bazuar në para të gatshme si dhe kornizën ligjore në fuqi. Veç kësaj, ka mjaft çështje tjera në menaxhimin e pasurive, të hyrave vetjake dhe procedurave të prokurimit.

4. Sistemi i Kontrollit të Brendshëm

Gjatë testimit për sistemin e kontrollit të brendshëm kemi zhvilluar intervista me menaxheret kryesor të Komunës dhe Auditorin e Brendshëm, kemi bërë shikimin e punës së auditorit të brendshëm, gjithashtu kemi analizuar organizimin e brendshëm të këtij institucioni si dhe kemi shikuar se ky institucion a ka nxjerre udhëzime të duhura për funksionim efikas.

5. Të hyrat

5.1. Hyrje

Tabela 1: Të hyrat e përgjithshme sipas P/F të Komunës

Klasifikimi i të Hyrave	Viti i mbaruar më 31 Dhjetor 2006
	(në €)
Të hyrat e Komunës nga burimet vetjake	1,809,658
Grandi i Qeverisë	6,882,702
Grandet e Përcaktuara të donatorëve	176,955
Totali i të Hyrave	8,869,316

Burimi i këtyre të dhënave është Raporti Vjetor i Komunës për vitin 2006 (Pasqyrat Financiare të Komunës për vitin 2006).

Të gjeturat dhe komentet e hollësishme për linja të ndryshme të hyrave janë të dhënat në vijim.

5.1.1 Të hyrat nga burimet vetjake të Komunës

Mbledhja e të hyrave bëhet në bazë të rregullores nr. 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave dhe me Rregulloren nr. 2003/29. Për tatimin e mbi pronën pa lujëshme në Kosovë..

Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2006 kanë qenë 2,198,000€ ndërsa të arkëtuara 1,556,432€ shprehur në % prej të hyrave të planifikuara janë arkëtuar 71% dhe të bartura nga viti 2005 kanë qenë 253,226€.

Të hyrat vetjake në vlerë prej 1 deri në 10 € arkëtohen përmes arkës ndërsa vlerat mbi 10€ përmes llogarisë bankare.

5.1.2 Të hyrat nga kadastra - Gjeodezia

Sipas pasqyrave financiare hyrat nga kadastra janë (kodi ekonomik 53421) në shume prej 126,832€, ndërsa sipas raportit të Komunës 127,209€ këto të dhëna rezultojnë diferencë prej 376€

Të gjeturat e hollësishme janë paraqitur në aneksin 1.

Në tabelën nr. 2 kemi bërë krahasimin e të dhënave në mes PF dhe shënimeve të komunës për të hyrat e arkëtuar ku edhe mund të vërehen diferenca në vlerë 12,987€ për të cilat komuna nuk ka dhënë shpjegime.

Tabela 2. Pasqyra e të hyrave të arkëtuara të Komunës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2006.

Kodi ekonomik	Emërtimi i të hyrave	Të hyrat Sipas P/F	Të arkëtuar Sipas shënimeve të Komunës	Diferenca
40202	Tatimi në shtëpi (në pronë)	478,693	477,910	(782)
40304	Tatim në Hotele restorante. dhe pije	17,715	17,790	75
40303	Të hyrat nga tatimi i shitjes	60	0	(60)
50001	Parkimi publik	345	0	(345)
50004	Taksa për leje të nder. -komunal	7,184	7,419	235
50006	Pjesëmarrja në tender	5,290	5,300	10
50011	Taksa për ndërrimin e tokës bujqësore	448	0	(448)
50020	Certifikata e lindjes	30,457	32,549	2,091
50021	Certifikata e kurorëzimit	14,151	14,156	5.00
50023	Certifikata tjera	7,489	7,297	(192)
50024	Verifikimi i dokumenteve. të ndryshme	10,286	10,297	11
50025	Fotokopjimi i dok të ndryshme	35	35	-
50026	Të hyra nga taksa administrative	13,912	11,746	(2,166)
50200	Lic. për fun. Dyq. të med. Shër. tj	21,133	20,732	(401)
50203	Lic. Për gurthyes dhe miniera	256	256	-
50204	Lic. për regjistrim të biznesit	30,754	30,892	138
50210	Lic. Për shërbimet profesionale	1,105	1,045	(60)
50220	Lic. Për shërbimet e transportit	1,850	1,940	90
52211	Donac. e mbren. kapitale + taksa. adm.-agrokultura	0	778	778
53200	Qiraja nga shfrytëzimi në prone	36,144	34,104	(2,040)
53210	Qira. e hap. pub. Per treg të hap.	37.676	39,416	1,740
53211	T.H. Qir. hp për vend obj. Tregt	14,490	14,885	395
53401	Inspektimi i artikujve ushqimor	5,463	6,012	549
53421	Aktiv. Ne teren që bëjnë ma. e vendit	126,832	127,208	376

Burimi i informacioneve për tabelën e dhënë më sipër është raporti i drejtorisë së financave dhe P/F të Komunës për vitin 2006.

5.2 Harmonizimet

Më poshtë është paraqitur një krahasim i shumave të shpenzimeve të regjistruara në sistemin e librit kryesor me shumatat e kontabilitetit të Komunës:

Tabela 3. Diferencat e shpenzimeve në mes të shënimeve të thesarit dhe Komunës

Kodi ekonomik	Përshkrimi i shpenzimeve	Shpenzimet sipas Thesarit	Shpenzimet sipas Komunës	Diferenca
13760	Dru	56,841	79,553	(22,711)
13780	Naftë	93,434	70,722	22,711
14030	Mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore	245,990	241,960	4,029
14040	Mirëmbajtja e teknologjisë informative	1,045	5,075	(4,029)
31120	Ndërtesa jo rezidenciale	365,609	329,047	36,561
31130	Struktura tjera	187,578	176,397	45,819
31200	Ndërtimi i rrugëve	161,459	176,397	(14,938)
31400	Ujësjiellësi	220,880	186,002	34,878

Diferencat e shpenzimeve të paraqitura në tabelën nr. 3 në vlerë 185,676€ është pasojë e regjistrimeve në kodet jo adekuate.

5.3 Të gjeturat e hollësishme të auditimit

Shqetësimet kryesore të auditimit kanë të bëjnë me dështimin për të mbledhur të hyrat apo edhe shfrytëzimin e fondeve të mbledhura. Konstatimi i auditorëve është se ka të hyra që mblidhen dhe shpenzohen pa hyrë përmes regjistrave financiar të Komunës.

Në aneksin 1. do japim disa shembuj sa iu përket këtyre shqetësimeve

6. Shpenzimet

Për vitin 2006 Komuna ka planifikuar të shpenzojë 9,048,797€, ndërsa ka shpenzuar 8,012,911€ të cilat përfshinë shpenzimet për paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, subvencione dhe transfere dhe shpenzime kapitale.

Në tabelën nr. 4 është paraqitur pasqyra e ekzekutimit buxhetor në bazë të linjave kryesore buxhetore.

Tabela 4 Shpenzimet sipas P/F të Komunës për vitin 2006

Përshkrimi i shpenzimeve	Të planifikuara	Të shpenzuara	Diferenca
Pagat dhe mëditjet	5,299,057	5,280,579*	18,478
Mallrat dhe shërbimet	1,229,096	1,172,350	56,746
Shpenzimet komunale	666,150	542,950	123,200
Subvencionet dhe transferet	240,000	137,564	102,436
Shpenzimet kapitale	1,614,494	879,468	735,026
Totali	9,048,797	8,012,911	1,035,886

* 5,280,579€ nuk përfshinë edhe vlerën e donacioneve për kategorinë e pagave dhe mëditjeve

6.1 Pagat dhe mëditjet

Shpenzimet e pagave që raportohen në pasqyrat financiare të Komunës për vitin 2006 (shuma totale e pagesave) ka qenë 5,287,837€.

Tabela nr. 5. shpenzimet mbi kategorinë e pagave dhe mëditjeve

Lloji i shpenzimit	Sipas L/K (thesari)
	Në euro
Pagat neto	4,529,048
Tatimi në pagë	161,726
Kontributi pensional- punëdhënësi	251,701
Kontributi pensional – punëtori	237,861
Paga me kontrate	1,814
Pagesat me orare te shkurtuar	14,372
Mëditjet e delegateve ne kuvend	45,200
Punëtoret me kontrate	46,112
Totali i pagesave	5,287,837*

* Vlera prej 5,287,837€ përfshinë edhe pjesën e donacioneve për paga dhe mëditje në vlerë 7,258€.

Si pjese e auditimit ne kemi rishikuar 29 dosjeve te personelit .

Ku edhe kemi konstatuar se 16 prej tyre ishin jo complete Për shkak se ju mungonin:

- Shënimet e pushimit vjetor nuk janë në dosje,
- Në 1 dosje se mungon raporti i vlerësimit,
- Në kontratat e punës ceket vetëm vlera e pagës e jo edhe koeficient,
- Të gjitha dosjet e personelit brenda një departamenti përmbajnë numrin e njëjte të kontratës.

6.2 Mallrat dhe Shërbimet, dhe Investimet Kapitale

Nga popullacioni në shumë prej 2,594,768€ ne kemi zgjedhur mostrën 17 për mallra dhe shërbime si dhe 10 nga investimet kapitale, vlera totale e tyre është 803,438€ ose 37% nga gjithsej popullacion.,

Numri i mostrave të marra për shpenzime të telefonave dhe para të gatshme janë paraqitur në aneksin nr. 1.

Auditimi i shpenzimeve tek “mallrat dhe shërbimet”, “shpenzimet kapitale” dhe “komunalit” është përqendruar ne atë për te pare se a janë në pajtim me rregulloret dhe ligjet vijuese:

- Ligji nr. 2003 “për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë”, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/17
- Ligji nr. 2003/17 “për Prokurimin Publik në Kosovë” i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/3.

7. Menaxhimi i Pasurive

Ne kemi bërë auditimin e menaxhimit të pasurive në komunë për të parë se a janë aplikuar ligjet dhe rregulloret në fuqi :

*

*

parregullsitë që kemi hasur janë paraqitur në aneksin 1 pika 7.1

8. Përcjellja e Implementimit të rekomandimeve nga ana e Menaxhmentit për auditimet e mëhershme

Në bazë të vrojtimit që i kemi pasur gjatë auditimit kemi vërejtur se nuk janë implementuar rekomandimet e auditorëve për aplikimin e dënimeve në rast të mospërbushjes së kontratave: si respektimin e procedurave për shfrytëzim të veturave, si dhe për përmirësimin e kontrollit të brendshëm.

Kufizimet

Të gjeturat tona të auditimit, mbështeten në dokumentacionin dhe informatat apo shpjegimet e tjera të cilat na janë ofruar gjatë procesit të auditimit. Është e mundur që të ketë edhe të dhëna të tjera shtesë e të cilat nuk na janë dhënë, gjë që kanë mundur të ndikojnë në ndryshimin e të gjeturave me të cilat kemi disponuar.

Të gjeturat e hollësishme të auditimit të përfshira në raport janë ilustrime të çështjeve kyçe që janë gjetur gjatë auditimit të pasqyrave financiare të Komunës, por që nuk duhet të merren se mund t'i shpalosin të gjitha çështjet e gjetura gjatë procesit të auditimit.

Aneksi 1			
Nr	Të gjeturat	Ndikimi	Rekomandimi
2.	Raportimi i të dhënave financiare		
	Ne kemi vërejtur se komuna nuk ka bere harmonizimin e shënimeve të saja me shënime të thesarit (free – balancit).	Komuna nuk ka aplikuar LMFPP Nga kjo kemi konstatuar se shënimet e komunës për shpenzime dhe të hyra nuk barazohen me shënimet e thesarit	ZRGJ-ja Rekomandon që aplikohet LMFPP qe ne të ardhmen të bëhet harmonizimi i shënimeve të komunës me ato të thesarit.
4.	Sistemi i Kontrollit të Brendshëm		
	Sistemi i kontrollit të brendshëm nuk është efikas, pasi që komuna nuk ka qenë në gjendje që ti parandaloj gabimet dhe parregullsitë që janë bërë siç janë shkeljet e LPP, LMFPP dhe menaxhimin e pasurive.	Mos aplikimi i plote i LPP , LMFPP dhe rregullores për menaxhimin e pasurisë jane si pasoje sistemit te dobetë te kontrollës se brendshme dhe keq menaxhimit.te fondeve dhe pasurisë se komunës	ZRGJ-ja Rekomandon që të aplikohen ligjet dhe rregulloret në fuqi qe do te rezultonte me përmirësim te sistemi te kontrollit të brendshëm e njëherazi edhe me menaxhim te mire te fondeve dhe pasurisë se komunës
4.1	Auditimi i Brendshëm si një segment me rendësi ne kuadër të kontrollit të brendshëm		
	Entiteti ka njësinë e Auditimit të Brendshëm me një punonjës të auditimit i cili është edhe kryesues i njësisë. Auditori është ekonomist por nuk është Auditori i Licencuar e as Kontabilistë i Certifikuar. Roli i NJAB është që të rishikoj procedurat dhe burimet e brendshme. Është vërejtur së entiteti nuk ka komitet të auditimit dhe në mungesë të këtij raporton tek menaxhmenti (komitetit për politik dhe financa). Bazuar në shqyrtimet tona kemi vërejtur se plani i auditimit të brendshëm për vitin 2006	Edhe pse komuna ka NJAB ne kemi konstatuar se për këtë njësi ka vend për përmirësim te me tutëjeshëm në fushën e raportimit, duke bere kualifikime stafit të auditimit. Përmirësim ne ruajtjen dhe mirëmbajtjen e letrave të punës dhe ate duke plotësuar standardet ndërkombëtare.	ZRGJ-ja Rekomandon që njësia e auditimit te brendshëm te ketë: - Trajnime te stafit për certifikim dhe licencim. - Te fokusohet në auditimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të entitetit. - Aprovuar planin e auditimit. - Ruajtura letrat e punese dhe raportet në forme elektronike, nëse nuk ka siguri brenda objektit të Komunës atëherë raportet të ruhen në kopje rezerve (CD) jashtë objektit

	nuk ka qenë i aprovuar nga krye-shefi. Auditori i Brendshëm ka përgatitur 5 raporte finale për drejtorit të ndryshme të komunës dhe një raport përmbledhës për periudhën janar dhjetor 2006.		te Komunës.
5.1	Të Hyrat Vetjake		
	<p>Të hyrat nga arsimi joformal dhe nga konvikti për vitin 2006 kanë qenë 64,693€ të cilat nuk janë prezantuar në pasqyra financiare e as nuk janë dorëzuar në llogari të BKK-së. Gjithashtu kemi vërejtur se këto mjete janë shpenzuar për nevoja të shkollës dhe konviktit pa u raportuar fare në komunë. Gjate testimi të faturave dhe kuponëve kemi vërejtur se kanë parregullsi siç janë: Kuponi me vlerë 1,070€ nr. 036818 i datës 03.11.2006 nuk dihet në emër të kujt është lëshuar si dhe vlera për njësi me vlerën totale dhe sasinë e blerë nuk paraqet gjendjen e vërtet. Gjatë ekzaminimit fizik inventari i blerë në vlerë 1,070€ në SHMM “HYSNI ZAJMI” Gjakovë nuk është dëshmuar se ekziston në këtë shkollë.</p>	<p>Mos prezantimi i të hyrave nga arsimi joformal dhe të hyrave nga konvikti në pasqyrat financiare ndikon në prezantimin jo real të pasqyrave financiare të Komunës dhe në BKK</p> <p>Kontrolli i dobëte i të hyrave e dëmton buxhetin komunale duke mundësuar keq menaxhimin e fondeve.</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon Komunës që të aplikojë nenin 10 dhe 13 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë duke bërë: - kontrollim , mbledhje dhe deponim të duhur të hyrave në llogarinë e BKK.</p> <p>Gjithashtu rekomandojmë që të gjitha të hyrat komunale të të përfshihen në Pasqyra Financiare dhe të gjitha blerjet duhet të bashkangjitur faturat së bashku me kuponë</p>

5.1.1	Të hyrat nga Tatimi në pronë		
	<p>Gjatë vitit 2006 janë lëshuar 20,472 fatura në vlerë prej 750,969 € ndërsa janë arkëtuar 8,511 fatura në vlerë prej 289,212€ respektivisht 41.5%.</p> <p>Ne kemi vërejtur se llogaritja e kamatës për tatimin në pronë nuk është bërë për të gjithë tatimpaguesit në baza mujore si dhe kalkulimet e bëra nuk janë llogaritur në baza mujore dhe të sakta.</p> <p>Nga pasqyra e të hyrave të arkëtuara për vitin 2006 vërehet së ka diferenca në mes të shënimeve të marra nga komuna dhe free - balance të cilat diferenca janë paraqitur në tabelën nr 2.</p>	<p>Nuk është aplikuar rregulloja e UNMK-ut 2003/29 e ndryshuar me rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/59.</p> <p>Mos llogaritja e kamatës në baza mujore si dhe kalkulimet jo të sakta kanë ndikuar që të hyrat nga kamata të jenë më të ulëta, kjo gjithashtu ka ndikim në prezantimin e P/F dhe BKK.</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që të aplikohet “Rregullorja e UNMIK – ut 2003/29 e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/59 për Tatimin në Pronë”, dhe aplikimin e kamatave për vonesat e pagimit të tatimit në pronë</p>
5.1.2	Të hyrat nga Kadastra - Gjeodezia		
	<p>Në një mostër të marrë nga kjo drejtori kemi vërejtur së nuk është bërë pagesa për faturën nr. 2/2007 në vlerë prej 488€ për kërkesën nr. 302/06 të datës 25.05.2006</p>	<p>Kërkesat për shërbime te kadastrave nuk kryhen sipas rregulloreve për përcaktimin e ngarkesave dhe tarifave komunale, shërbimet janë kryer pa bërë pagesën e kërkuar dhe pa kompletuar tere dokumentacionin</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon të aplikohet rregullorja qe përcakton dhe ngarkesat për shërbime kadastrave</p>
5.1.3	Të hyrat nga shëndetësia		
	<p>Të hyrat nga participimet në shërbime shëndetësore për vitin 2006 janë 48,488€.</p> <p>Gjatë ekzaminimit ne kemi vërejtur së dëftesat nuk janë të nënshkruar dhe të plotësuara.</p> <p>Po ashtu kemi vërejtur se bllokat nuk dorëzohen me kohë.</p>	<p>Kjo ndikon në paraqitjen e gjendjes jo reale të hyrave nga shëndetësia dhe prezantim jo të drejt ne raportimet periodike.</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që dëftesat të plotësohen sipas rregulloreve dhe bllokat të dorëzohen brenda afateve te parapara kohore.</p>

6.	Mallra dhe Shërbime		
6.1	<p>Në kontratën e nënshkruar me datën 17.04.2006 për furnizim me material ushqimor dhe higjienë pjesa e II më vlerë prej 4€ çmimi për njësi kemi vërejtur disa parregullsi siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kompania fituese ka ofruar çmim vetëm për njërin artikull të pjesës së dytë e jo për dy artikujt siç është kërkuar në specifikacion, operatorët tjerë kanë ofruar çmim për dy artikujt mirëpo nuk kanë fituar tenderin, - Vazhdimi i kontratës si aneks është bërë me datën 18.04.2007 edhe për një vit. 	<p>Ne kemi konstatuar se ne këtë tender është bërë eliminimi i ofertave të përgjegjshme dhe vazhdimi i kontratës edhe për një vit për ofertuesin e papërgjegjshëm</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që të aplikohet neni 57.3 I LPP 2003/17 që autoriteti kontraktues të vlerësojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit.</p>

6.2	<p>Në kontratën e nënshkruar me datën 26.04.2006 për Riparim dhe mirëmbajtje të automjeteve zyrtare në vlerë prej 17,711€ për njësi kemi vërejtur këto parregullsi siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në kontrate nuk është specifikuar vlera totale e kontratës. - Sigurimi i ofertës dhe ekzekutimit nuk është kërkuar. - Kërkesa është e panënshkruar nga drejtori për buxhet dhe financa.. - Faturat janë të panënshkruara nga personi i cili e ka bërë pranimin. -Fatura nr. 029404 e datës 13.03.2006 në vlerë 2,225 nuk dihet se për cilin automjet është bërë pagesa. 	<p>Ne kemi konstatuar se Mungesa e sigurimit të ekzekutimit, kërkesat e pakompletuara,si dhe faturat e pidentifikuara dhe të panënshkruara janë pasoje e mos funksionimit të te duhur te sistemit të kontrollit të brendshëm.</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon Komunën që të aplikoj nenin 60.2 dhe 60.4 te LPP 2003/17 për sigurimin e ekzekutimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të specifikohet vlera totale e kontratës - Faturat të plotësohen qartë në emër të kujt janë lëshuar dhe të nënshkruhen nga personi i cili bënë pranimin.
-----	---	---	---

6.3	<p>Në kontratën e nënshkruar me datën 01.07.2006 për furnizim vjetor me derivate të naftës çmimi për njësi është 6.31€ kemi vërejtur parregullsitë siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Nuk është specifikuar vlera totale në kontratë. - Në kontratë nuk ka qenë i parapare ndryshimi i çmimit të derivateve sipas lëvizjes së çmimit të berëzës. - Kërkesa për blerje (shpenzimet për derivate) është e panënshkruar nga Krye-shefi dhe drejtori për Buxhet e financa - Regjistri i operatorëve ekonomikë që kanë pranuar dosjen e tenderit është i panënshkruar nga zyrtari i prokurimit. 	<p>Ne kemi konstatuar se Kontrata është nënshkruar pa aprovim të kërkesës për blerje nga personat përgjegjës, dhe është bërë ndryshimi i çmimeve duke mos respektuar kushtet e kontratës. Si pasoje e mos funksionimit të kontrolleve të duhura, për ti parandaluar gabimet.</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që në kontrata të specifikohet vlera totale e kontratës dhe të zbatohen kushtet e parapara të kontratës.</p>
6.4	<p>Në kontratën e nënshkruar me datën 28.07.2006 për furnizim me dru për ngrohje dhe sharritjen e tyre në vlerë totale prej 48,251€ (çmimi për metër 33.30€). Autorizimi për CPO nr. 46650 në vlerë 1,332€ nuk ka qenë korrekt (nuk është ofruar dëshmi së personi i cili ka bërë autorizimin e ka pasur nënshkrimin e deponuar në thesar).</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aneks kontrata është nënshkruar më datën 01.09.2006 në vlerë 3,663€. 	<p>Ne kemi konstatuar se autorizimi nuk është bërë nga personi i autorizuar.</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që personat që bëjnë autorizimin e shpenzimeve të kanë të deponuar nënshkrim në thesar si autorizues.</p>

6.5	<p>Në Kontratën e nënshkruar me datën 22.08.2006 për ndërtimin e qendrës familjare në Dardani – Piskote në vlerë 69,827€ ndërsa aneksi është nënshkruar me datën 27.11.2006 në vlerë 6,952€ kemi vërejtur parregullsitë siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fillimi i procedurave të prokurimit pa siguruar lejen e ndërtimit, - Nuk na janë prezantuar dëshmi bindëse se ka qenë i arsyeshëm ri-tenderimi. - Për vonesa në kryerjen e punëve nuk na është afruar ndonjë arsyetim dhe nuk janë aplikuar penalet, përkundër kësaj është nënshkruar aneks kontrata. 	<p>Kemi konstatuar se penalet për vonesa nuk janë aplikuar, gjithashtu në dosje mungojnë arsyetimet për vonesa dhe ritenderim.</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që Komuna për ndërtime të sigurojë me kohe lejet e ndërtimit si dhe të aplikimin penaleve për vonesa në punë.</p>
6.6	<p>Kontrata e nënshkruar me datën 14.08.2006 për rekonstruim - asfaltimin e rrugëve Luigj Gurakuqi dhe Mihal Grameno në vlerë 67,919€ ndërsa aneks kontrata është nënshkruar në vlerë 4,199€ me datën 27.11.2006 kemi vërejtur parregullsitë siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Punët nuk janë kryer sipas planit dinamik dhe nuk na është ofruar dëshmi se ka pas ndonjë arsye për vonesa në kryerjen e punëve. - Për te cilat vonesa nuk janë aplikuar penalet. - Sipas faturës së datës 05.12.2006 në vlerë prej 4,199€ është bërë pagesa e aneks kontratës ku punët e aneksit janë kryer para së të kryhen punët e kontratës baze (punët e kontratës janë kryer me datën 19.12.2006 në faturën pa numër në vlerë 13,549€ pas përfundimit të aneksit. 	<p>-Penalet për vonesa në punë nuk janë aplikuar për te cilat nuk ka dëshmi për arsyetimin e tyre. -Pagesa e aneks kontratës është bërë para përmbushjes së kushteve në kontrate.</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që të te aplikohen penalet për vonesat e mbarimit të punëve.</p>

6.7	<p>Në kontratën e nënshkruar me datën 04.12.2006 për asfaltimin e rrugës në fshatin Fierzë në vlerë prej 219,219€ kemi vërejtur këto parregullsitë siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kërkesa për aprovim të shkurtimit për afat kohor është bërë për vlerën 110,000€ ndërsa kontrata është nënshkruar në vlerë prej 219,219€ - Punët nuk janë kryer sipas kohës së paraparë në kontratë dhe sipas specifikacioni,(nuk është shtruar trashësia asfaltit sipas kontratës). - Nuk është ofruar ndonjë dokument (dëshmi si do të kryhen punët deri në vlerën totale të kontratës). - Zotimi është bërë vetëm për vlerën 30,000€. - Autorizimet në CPO jo korrekte. - Personi i njëjtë në dy komisione të vlerësimit dhe të organit mbikëqyrës. - Sigurimi i tenderit nuk është bërë në vlerën totale të kontratës por është bërë vetëm për vlerën e zotimit të mjeteve. - Garancioni bankar nuk ka datë. 	<ul style="list-style-type: none"> - Nuk janë respektuar vlerat e aprovuara për shkurtimin e afatit kohor. -Kontrata e nënshkruar më e lartë se sa aprovimi në vlerë prej 109,219€. - Nuk janë aplikuar penalet për vonesa të kryerjes së punëve. - Fillimi i procedurave të prokurimit pa zotim paraprak të mjeteve. - Nuk ka dëshmi kur është lëshuar garancioni bankar. 	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që të aplikohen vlera e kërkesës për aprovim të shkurtimit të afatit kohorë.</p> <p>Të zbatohen kushtet e kontratës dhe të specifikohet qartë si do të realizohet deri në vlerën totale.</p> <p>Të aplikohet neni 8 i LPP 2003/17.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Autorizimin në CPO ta bëjnë personat që kanë të deponuar nënshkrimin në thesar si autorizues. - Personat e njëjtë të mos janë në dy komisione. - Të aplikohet neni 60.2 i LPP 2003/17 që autoriteti kontraktues të sigurojë që shuma e sigurimit të ekzekutimit të jetë më së paku 10% e vlerës së kontratës. - Garancioni bankar të këtë datë.
6.8	<p>Në Kontratën e nënshkruar me datën 25.08.2006 për punimin e planit rregullues në mes të rrugëve “Sadik Stavileci” dhe “UÇK” në vlerë 23,287€ e cila përmban edhe aneks kontratë në vlerë 1,700€ kemi hasur vërejtjet siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Personi i njëjtë në dy komisione në të vlerësimit dhe të organit mbikëqyrës. - Mungon kërkesa për sigurim të ekzekutimit të kontratës. 	<p>Ne kemi konstatuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Se nuk është bërë ndarje e duhur e detyrave,dhe sigurimi r ekzekutimit të kontratës. 	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që personat e njëjtë të mos janë në dy komisione (te vlerësimit dhe organit mbikëqyrës).</p> <p>-Të aplikohet neni 60 i LPP 2003/17 për sigurinë e ekzekutimit të kontratës.</p>

6.9	<p>Në kontratën e nënshkruar me datën 11.07.2006 për punimin e planit rregullues urban në rr. “Tirana”-transit në Gjakovë në vlerë prej 24,750€ dhe aneksi i nënshkruare më datën 27.11.2006 në vlerë prej 2,475€ kemi vërejtur këto parregullsi :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nuk janë kryer punët sipas afatit të parapare në kontratë. - Nuk janë aplikuar penalët (ka pasur vonesa tre muaj për kryerjen e punëve). 	Mos aplikimi i penaleve ndikon që operatorët ekonomik të mos i zbatojnë afatet kohore për kryerje të punimeve me kohë.	ZRGJ-ja Rekomandon që të aplikohen penalet për vonesa në punë.
6.10	<p>Në kontratën e nënshkruar me datën 11.12.2006 për “Furnizim me shtylla dhe tel për ngritjen e pemishteve intensive në Gjakovë” kemi vërejtur se dy prej anëtareve të komisionit të vlerësimit janë edhe anëtare të organit mbikëqyrës.</p>	Marrja pjese e personave te njëjte në dy komisione konsiderohet konflikt interesi.	ZRGJ-ja Rekomandon që personat në komision të vlerësimit të janë të ndryshëm nga personat e organit mbikëqyrës.
6.11	<p>Në kontratën e nënshkruar me datën 04.04.2005 e cila vlen deri me 04.04.2006 për Furnizim me fidanë të druve Dekorues dhe lule për nevojat e Kuvendit Komunal Gjakovë.</p> <p>Kemi vërejtur këto parregullsi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sipas komisionit të vlerësimit nuk kanë qenë tri oferta të përgjegjshme, - Në aneks kontratën e nënshkruar me datën 05.04.2006 nuk është specifikuar vlera e aneks kontratës prandaj nuk është e qartë sa do të kushtojë aneks kontrata. 	Edhe pse kane qenë më pak se tri oferta të përgjegjshme nuk është anuluar aktiviteti i prokurimit (nuk është respektuar neni 33.8 i LPP 2003/17). Aneks kontrata nuk ka vlerë e cila do të mund të arsyetonte 10% e lejuar për anekse.	ZRGJ-ja Rekomandon që të aplikohet neni 33.8 i LPP 2003/17 nëse janë pranuar me pak së tre tender të përgjegjshëm autoriteti kontraktues të anuloje aktivitetin e prokurimit, me ç’rast nëse autoriteti kontraktues dëshiron që të prokuroje lendet përkatëse duhet të filloje një aktivitet të ri të prokurimit për lendet e tilla. - Në aneks kontrata të specifikohet vlera e aneksit.

6.12	<p>Në kontratën e nënshkruar me datën 15.12.2006 për furnizim me uniforma për brigadën e zjarrfikësve Kemi vërejtur këto parregullsi: -Nuk na është ofruar asnjë dëshmi e komisionit të vlerësimit për anulim të tenderit gjithashtu kemi vërejtur se edhe gjatë ritenderimit ka pasur parregullsi siç janë: - Kriteri i çmimit me të ulet nuk është aplikuar . Firma e cila ka ofruar çmimin në vlerë 10,960€ qe sipas komisionit të vlerësimit e kishte dokumentacionin e kompletuar dhe llogaritjet e sakta e cila edhe pse ka ofruar çmimin me te ulet nuk është shpërblyer. Por është shpërblyer firma qe ka ofruar çmimin ne vlere prej 19,485 e cila ishte me e shtrenjte se dy firma tjera. - Zotimi i mjeteve është bërë pas nënshkrimit të kontratës.</p>	<p>-Anulimi i tenderit është bërë pa ndonjë arsye të dëshmuar. - Nuk është aplikuar ligji i prokurimit publik 2003/17 për shpërblimin e ofertës me të përgjegjshme, - Është dëmtuar buxheti komunal për vlerën 8,525€ si rezultat i shpërblyerimit te firmës me çmim me te larte ..</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që arsyeja (dokumenti i vlerësimit të komisionit) për eliminim të tenderit tu prezantohet auditorëve dhe mos të bëhen anulime për derisa nuk kane dëshmi për anulime. - Të aplikohet kriteri i çmimit me të ulët i kërkuar në specifikacion (Neni 50 i LPP 2003/17). - Zotimi i mjeteve të bëhet para nënshkrimit të kontratës.</p>
6.13	<p>Në kontratën e nënshkruar me datën 11.11.2006 në vlerë totale prej 601,534€ për ndërtimin e bibliotekës regjionale në Gjakovë. Kemi vërejtur disa parregullsi siç janë: - Mjetet janë zotuar pjesërisht vetëm deri në vlerën 194,770€ e jo për tërë vlerën e kontratës. - Nuk ka dëshmi për sigurimin e ekzekutimit në vlerën prej 10% siç është kërkuar në kriteret e përcaktuara. - Nuk ka dëshmi se kush do ti paguaje pjesën e obligimeve qe dalin nga kontrata mbi vlerën 194,770€, ndërsa në kontratë është parapare afati i përfundimit të punëve për 5 muaj i cili nuk është zbatuar .</p>	<p>- Nuk është respektuar LPP 2003/17 për fillimi i procedurave të prokurimit, zotimi i mjeteve nuk është bërë me kohe,si dhe sigurimi i ekzekutimit nuk është bere ne vlerën e kërkuar. - Nënshkrimi i kontratës është bërë pa definuar se kush do ti kryej obligimet deri në vlerën totale te kontratës. - Nuk është zbatuar afati kohor për përmbushjen e kontratës.</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që të aplikohet neni 8.2 i LPP 2003/17 ku fondet për prokurimin përkatës duhet te jene te zotuar ne shumen e mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve qe dalin nga kontrata. - Të aplikohet neni 60 i LPP 2003/17 për sigurimin e ekzekutimit të kontratës. - Në CPO të nënshkruajnë vetëm, personat e autorizuar, ose autorizuesit alternativ.</p>

	- Nuk kanë ofruar dëshmi për personin i cili ka nënshkruar si autorizues në CPO me nr. 60518, se e ka nënshkrimin e deponuar në thesar si autorizues.		
6.14	Prokurimet me vlera minimale		
	<p>Shpenzimet për vlera minimale sipas raportit vjetor kanë qenë në vlerë prej 14,224€.</p> <p>Nga 40 kontrata kemi zgjedhur 6 mostra në vlerë 1,271€ respektivisht 15% e vlerës totale për prokurimet me vlera minimale. Në 3 prej 6 mostrave të ekzaminuar kemi vërejtur parregullsitë siç janë:</p> <p>-Në kontratën nr. 06/6 për Riparimin e pompës në Gjimnazin “Hajdar Dushi” e nënshkruar me datën 08.03.2006 në vlerë prej 458€ për këtë kontratë mungon data për pranimin e punëve të kryera.</p> <p>- Në kontratën nr. 10/06 për blerjen e printerit të nënshkruar me datën 16.03.2006. Fatura nr. 24 në vlerë prej 460€ është e panënshkruar nga pranuesi i mallit.</p> <p>- Në kontratën nr. 28/06 për furnizim me kompjuter e datës 07.08.2006. Fatura Nr. 49 në vlerë prej 400€ është e panënshkruar nga personi i cili ka bërë pranimin e faturës.</p>	- Raportet e pranimin dhe faturat nuk janë plotësuar siç kërkohet ne rregullore menaxhimi i tille krijon hapësire për dyshime te keqpërdorimit	ZRGJ-ja Rekomandon që faturat të janë të nënshkuara nga personat që bëjnë pranimin dhe të mos jenë pa datë.

7.	Menaxhimi i Pasurisë		
7.1	<p>Gjate auditimit të menaxhimit të pasurive në komunë kemi gjetur këto parregullsi :</p> <p>Nuk arritëm të sigurojmë dëshmi bindëse se të gjitha pasuritë e blera janë regjistruar.</p> <p>-Një pjesë e pasurive nuk i kanë të vendosur barkoret.</p> <p>- Nuk është llogaritur zhvlerësimi.</p> <p>-Kemi vërejtur se një pjesë e aparaturës nuk funksionon</p> <p>-Ka aparate që nuk janë futur asnjëherë në përdorim (siç është rasti i rëntgenit i cili është blerë në vitin 2004 vlera e të cilit është 102,800€), blerja e rëntgenit është bërë pa kërkesë prej QKMF.</p>	<p>Nuk ka dëshmi bindëse së të gjitha pasuritë janë të regjistruar, si pasojë e keq menaxhimit në planifikimin e blerjeve dhe të shfrytëzimit të pajisjeve një pjesë e aparaturës mjekësore kanë mbetur pa u futur në përdorim.</p> <p>Mos shfrytëzimi i pajisjeve të blera krijojnë shpenzime të pa arsyeshme.</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që të zbatohet Instruksioni Administrativ – Menaxhimi dhe Regjistrimi i Pasurive Qeveritare 2005/11 të bëhet</p> <p>- Regjistrimi i pasurisë që disponon komuna në sasi dhe vlerë.</p> <p>- Të llogaritet norma e zhvlerësimit.</p> <p>- Të mos bëhen blerje pa kërkesë.</p> <p>- Pajisjet e blera duhet të shfrytëzohen për nevojat e parapara në mënyrë që të bëhet shfrytëzimi sa më efikas i pajisjeve dhe të arsyetohet investimi.</p>
7.2	<p>Shfrytëzimi i veturave</p> <p>Administrata komunale e Gjakovës nuk ka shef të autoparkut.</p> <p>- Sipas shënimeve të cilat na janë ofruar, kemi vërejtur se komuna ka lejuar furnizime me karburante për vetura private të cilat kanë qene të shpeshta. Numri i veturave që janë furnizuar me derivate është 140, për të cilat nuk janë arsyetuar kilometrat e kaluara për qëllimin e udhëtimit.</p> <p>- Shpenzimet për derivate të veturave private kanë qenë 23,428 ndërsa shpenzimet për furnizime të veturave zyrtare kanë qenë 21,779.</p> <p>- Një një numër i veturave të komunës nuk janë në gjendje të rregullt.</p>	<p>Veturat private të cilat janë furnizuar në emër të Komunës kanë bërë shpenzime me të larta për 1,649 se sa veturat zyrtare.</p> <p>Lejimi i furnizimeve të shpeshta me derivate të veturave private krijon mundësi për keqpërdorim.</p> <p>Mungesa e shefit të autoparkut ndikon që shpenzimet të rriten si pasojë e mosfunksionimit të kontrollit të duhur për menaxhimin e automjeteve</p>	<p>ZRGJ-ja Rekomandon që furnizimi me derivate të bëhet vetëm për vetura zyrtare.</p> <p>Të caktohet personi përgjegjës për shef të autoparkut i cili do të menaxhonte përdorimin e automjeteve ..</p>

8.	Shpenzimet tjera		
8.1	<p>Shpenzimet e parasë së gatshme Shpenzimet e parasë së gatshme për vitin 2006 kanë qenë 18,936€.</p> <p>Ne kemi ekzaminuar 56 mostra në vlere prej 3,528€ apo 19% e vlerës është ekzaminuar, prej tyre 40 mostra janë marre ne administratën komunale vlere e shpenzuar ka qenë 15,000€ prej tyre 29% janë shpenzuar për dreka zyrtare. Vlora e ekzaminuar e mostrave ka qenë 2,497€ respektivisht 17% .</p> <p>Në shëndetësi kemi ekzaminuar 16 mostra, Shpenzimet e parasë së gatshme në shëndetësi kanë qenë 3,936€ ndërsa vlora e ekzaminuar ka qenë 1,028€ respektivisht 26%. Për shpenzimin e parësë së gatshme kemi vërejtur këto parregullsi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fatura e datës 20.11.2006 në vlere prej 31€ është e panëshkruar. - Fatura e datës 08.11.2006 në vlerë 60€ për blerje te gomave reglazzh për vetura . - Fatura e datës 24.10.2006 në vlerë 40€ për blerje të kartelave për telefona . - Kërkesa e datës 30.01.2006 është pa numër është nënshkruar për furnizim me derivate në Ohër, ndërsa furnizimi është bërë në Gjakovë me datën 11.01.2006 në vlerë prej 26€. - Kërkesa e datës 14.02.2005 në vlerë prej 10 euro për mbushje telefoni është pa numër. - Kërkesa e datës 20.11.2006 ne vlere 31€ është pa numër dhe e panëshkruar. <p>Ne gjithashtu kemi vërejtur se nga paraja e gatshme janë bere furnizime me derivate dhe</p>	<p>Nuk është respektuar “Rregulla financiare dhe udhëzimet e thesarit – 02 Shpenzimi i parave Publike për Shpenzimin e Parave të imëta.”</p>	<p>Rekomandojmë që të aplikohet rregulla financiare dhe udhëzimet e thesarit – 02 Shpenzimi i parave publike për shpenzimin e parave të imëta.</p> <p>Gjithashtu rekomandojmë komunën qe te ngrit kontrollin e brendshëm per shpenzimin e parasë se imet duke mos lejuar ;</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpenzime te cilat mund te bëhen përmes procesit normal. - Blerjet pa kërkesë - Ndarje të faturave ne pjese. - Blerje të druve dhe furnizim me derivate nga parja e gatshme deri sa ekziston kontrata për to.

	dru edhe pse ka pas kontratë për furnizim te tyre Gjithashtu kemi vërejtur se për shpenzime te parasë se gatshme ka pasur ndarje të faturave në dy pjesë.		
8.2	<p>Shpenzimet e telefonit Komuna ka një “Udhëzues intern mbi procedurat interne të menaxhimit financiar”, i cili ka hyrë në fuqi me 09.03. 2006. Në pikën 9. të udhëzimit përcaktohen çështjet e përdorimit të telefonave në të cilën nuk janë parapare shpenzimet për telefona roming, mirëpo për periudhën para nxjerrjes se këtij udhëzimi nuk na është prezantuar ndonjë rregullore apo udhëzim për shpenzimet e telefonave. Shpenzimet e telefonave kanë tejkaluar limitin e lejuar udhëzuesin e lartpërmendur. Për shpenzimet e telefonisë fikse nga lista e prezantuar gjithsej 49 mostra janë zgjedhe 10 mostra në 8 prej tyre kemi vërejtur se ka pasur tejkalime të limit të shpenzimeve, Shpenzimet e mostrave të zgjedhura për 7 muaj kanë qenë 3,468€ vlera e tejkaluar në këto mostra ka qenë 1,477€ që është 43% mbi limitin e lejuar te shpenzimeve. . - Shpenzimet e telefonave roming sipas kartelës financiare për periudhën 25.01.2006 deri me 19.12.2006 ka qenë 6,472€.</p>	Nuk është aplikuar pika 9 e udhëzimit intern mbi procedurat e menaxhimit financiar që përcakton çështjen e përdorimit të telefonave prej datës 09.03.2006 para kësaj datë komuna nuk është bazuar në ndonjë rregullore apo udhëzues për shpenzime të telefonave.	ZRGJ-ja Rekomandon që të aplikohet pika 9 e udhëzimit intern mbi procedurat e menaxhimit financiar, të mos tejkalohen limitet e lejuara ne udhëzimin intern.

Komentet e Komunës

Komunës së Gjakovës iu ka dhënë mundësia për dhënien e komenteve ne draft raportin e auditimit në mënyrë që të eliminohet rreziku i keqinterpretimit dhe keqkuptimit në mes te auditorëve dhe entitetit të audituar .

Komuna ka bërë komentet e saja dhe ato janë përfshirë në këtë raport .

Komuna nuk është pajtuar me disa nga të gjeturat tona ,por komentet e tyre nuk japin dëshmi në mënyrë që ndikojnë në ndryshimin e opinionit të dhënë nga auditori.

Aneksi 2 Përgjigja ndaj komenteve të Komunës

Referenca	Komentet nga Kuvendi Komunal Gjakovë	Komentet e ZRGJ-së
2	Komuna ka bere harmonizimin e shenimeve me Fre - balance per vitin 2006.	Konstatimet e ZRGJ-së mbesin. Shënimet e Komunës për shpenzime dhe te hyra nuk barazohen me shënimet e thesarit.
5.1	Konvikti nuk ka qen ne competence te Drejtoris por te MASHT-ti. te hyrat nga mesimi jo formal jane grumbulluar ne llogarine e MASHT - tit te hapur enkas per kete qellim. sa i perket Inventarit te shkolle al ndodhet ne shkolle.	Konstatimet e ZRGJ-së mbesin. Shpenzimet dhe te hyrat nga konvikti dhe arsimi joformal nuk janë paraqitur në Pasqyra financiare Gjate ekzaminimit tonë inventari nuk është dëshmuar se ekziston në shkolle.
5.1.1	Kamatat jane te llogaritura slpas udhezimeve te MEF-it.	Konstatimet e ZRGJ-së mbesin. Nuk është aplikuar rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/29 e ndryshuar me rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/59.
5.12	Te gjitha te hyrat arketohen sipas rregullores komunale mbi tarifa dhe ngarkesa.	Konstatimet e ZRGJ-së mbesin. Nuk është bërë pagesa për shërbimet e kryera .
7.1	Pasurit e blera gjate vltit 2006 jane te regjistruara dhe kane Barkodet, zhvleresimin behet nga niveli qendror Fre- balance	Konstatimet e ZRGJ-së mbesin se një pjese e pasurive nuk kane te vendosura barkode, dhe nuk është llogaritur zhvlerësimi.
7.2	Automjetet private perdoren slpas rregul/ores interne ku nuk kerkohet kllometrazh por sasia e derivateve epet si pas largesise se qytetit. Perdorlmi I automjeteve private si pasoj e mungeses se automjeteve zyrtare.	Konstatimet e ZRGJ-së mbesin. Lejimi për furnizime të shpeshta me derivate te veturave private krijon mundësi për keqpërdorime.